



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:014919  
Datë: 14.02.2025  
Numri i dokumentit: 06849988

CAP.nr.1979/24

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË- me gjyqtarin individual Fatmir Baloku, në çështjen juridiko-civile përmbare të kreditorit N. B. nga Hani i Elezit, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat Q. B. nga Kaçaniku, rruga ..... “...”, kundër debitorit Komuna Hani i Elezit, lidhur me çështjen përmbare, kërkesë në të holla, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik-Departamenti i Përgjithshëm, E.nr.9/2023, të datës 04.10.2024, me datë 13.02.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET ankesa e kreditorit N. B. nga Hani i Elezit, e ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik-Departamenti i Përgjithshëm, E.nr.9/2023, të datës 04.10.2024, SI E PA AFATSHME.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik-Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar E.nr.9/2023, të datës 04.10.2024, ka vendosur si vijon: APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit, Komuna Hani i Elezit – Drejtoria për Buxhet dhe Financa, i ushtruar më datë 31.01.2023, SHFUQIZOHET aktvendimi mbi lejimin e ekzekutimit E.nr.09/2023, i datës 18.01.2023, dhe anulohen të gjitha veprimet e ndërmarra përmbare, ndërsa propozimi për përmbare i kreditorit N. B., REFUZOHET si i pabazuar. Ndërsa me aktvendimin E.nr.9/2023, të datës 14.10.2024, ka vendosur si vijon: I. PËRMIRËSOHET Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik E.nr.09/2023 i datës 04.10.2024, ashtu që në hyrje të aktvendimit në faqen 1, në vend të emërimit PPP, duhet të jetë emërtimi nën shkronjën E si dhe në fund të aktvendimit në faqen 4, në vend të emërimit PPP duhet të jetë po ashtu emërtimi nën shkronjën E. II. Pjesa tjetër e këtij aktvendimi mbetet e pa ndryshuar.

Kundër aktvendimit E.nr.9/2023, të datës 04.10.2024, ka ushtruar ankesë kreditori, me propozim që ankesa e kreditorit të aprovohet si e bazuar dhe aktvendimi mbi lejimin e përmbare të lihet në fuqi.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur debitori, me propozim që ankesa e kreditorit të refuzohet si e pa bazuar dhe aktvendimi i atakuar të vërtetohet.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194, 196 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pa afatshme.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datë 17.01.2023, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit në bazë të dokumentit përmbartues- vendimet e Kuvendit Komunal: vendimit ..., të datës 29.12.2020 dhe vendimit ..., të datës 03.02.2021.

Gjykata me aktvendimin E.nr.09/23 të datës 18.01.2023, e ka lejuar propozimin për përmbartim.

Kundër aktvendimit për lejimin e përmbartimit, debitori me datën 31.01.2023 ka ushtruar prapësim, ndërsa kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në prapësim.

Gjykata Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik-Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar, E.nr.9/2023, të datës 04.10.2024, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit, *(duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi)*.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, konstatoi se i autorizuari i kreditorit aktvendimin e atakuar E.nr.9/2023, të datës 04.10.2024, e ka pranuar me datën 07.10.2024, ndërsa ankesën kundër aktvendimit e ka dorëzuar në gjykatë me datën 23.10.2024, pas kalimit të afatit 7 ditë për paraqitjen e ankesës. Si datë e fundit për paraqitjen e ankesës ka qenë data 14.10.2024, që do të thotë se ankesa e kreditorit është paraqitur pas afatit të paraparë ligjor dhe se për të njëjtën nuk ka prova në shkresa të lëndës se është dorëzuar nëpërmjet postës.

Sipas nenit 77 paragrafi 2 të LPP-së, është përcaktuar se: *“ankesa kundër vendimit mbi prapësimin parashtrohet përmes Gjykatës së shkallës së parë për Gjykatën e shkallës së dytë, në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit”*. Gjykata e Apelit vendosi duke u bazuar në nenin 186 paragrafi 2, të LPK-së, sipas të cilit *ankesa është e pa afatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj*, si dhe nenit 196, të LPK-së, ku është përcaktuar se: *“ankesën e vonuar, jo të plotë, apo të palejueshme, e hedhë poshtë gjykata e shkallës së dytë me aktvendim, po që se nuk e ka bërë një gjë të tillë gjykata e shkallës së parë siç është parashikuar në (nenin 186)”*, andaj, pasi që në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk e ka vlerësuar afatshmërinë e ankesës dhe të njëjtën nuk e ka hedhur si të pa afatshme, sipas ligjit vendosi gjykata e shkallës së dytë.

Nga sa u tha me lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209 pika a), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
CAP.nr.1979/24, me datë 13.02.2025

Gjyqtari  
Fatmir Baloku d.v